

PROJEKT MARREVESHJE
PER : NDARJEN E SHOQERISE
"Premium Finese" Shpk

Kavaje me 11.02.2025

Shoqeria "Premium Finese" Shpk eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me dt. 31.10.2019, me seli: Tirane Golem Kryemedhenj Hotel "Premium" Kryemedhenj, Golem, Kavaje.

Shoqeria **"Premium Finese" Shpk** me NIPT-in L93431803M , me Administrator z. Arben Meçaj, aktualisht ka nje Kapital themeltar prej 100.000 leke, me ortake Enver Mehmeti me 1 (nje) kuote, 60% te kapitalit 60.000 leke dhe Arben Meçaj me 1 (nje) kuote, 40% te kapitalit me 40.000 leke

Pas bisedimesh paraprake eshte rene dakort per ndarjen e kesaj shoqerie, ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" te nenit 227 pika 1 ne dy shoqeri pritese dhe konkretisht:

Ne Shoqerine pritese "Sunrise Beach Hotel" shpk egzistuese me Nipt-in M51322020O regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 22.01.2025

Ne Shoqerine pritese "Luxury Premium Finese" shpk shoqeri egzistuese me Nipt-in M52520805R regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 20.01.2025

Ne zbatim te nenit 216 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" hartohet ky projek per ndarjen e shoqerise me keto kushte :

1. **Ndarja** do te kryhet ne formen e shkeputjes ku shoqeria **"Premium Finese" Shpk** do te jete mema (ndaresja) ndersa shoqerite **"Sunrise Beach Hotel" shpk** dhe **"Luxury Premium Finese" shpk** do te jene shoqeri pritese (bija, te ndara). Shoqeria **"Premium Finese" Shpk** qe ndahet vleresohet e prishur, ne zbatim te nenit 227 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".
2. **Raporti kembimit** te kuotave do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" nenit 68 pika 2, ku çdo ortak ka nga 1(nje) kuote, dhe mbi bazen e vleres se kuotes te sejcilit ortak qe ka para ndarjes, kalon edhe ne shoqerite pritese nga ndarja (si numer dhe vlere kuote ne shoqerite me pergjegjesi te kufizuar).
3. **Kushtet e ndarjes** te kuotave te shoqerise do te jene ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" nenit 68 pika 2, ku çdo ortak ka nga 1(nje) kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerive pritese nga ndarja,do jete mbi bazen e raportit qe ze vlere se jeciles kuote ne kapitalin themeltar ndaj totalit te kapitalit themeltar te shoqerive pritese me pergjegjesi te kufizuar.
4. **Data**, duke u nisur nga e cila zotëruesit e kuotave (ortaket e shoqerive ne shoqerite e reja qe krijohen pas ndarjes) kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit qe do te jete 01.01.2025.
5. **Data**, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë pritese **"Sunrise Beach Hotel" shpk** dhe shoqeria pritese **"Luxury Premium Finese" shpk** që dalin nga ndarja do të trajtohen nga

pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë ndarese **“Premium Finese” Shpk** do të jete 01.01.2025.


6. **Të drejtat** që shoqëria pritesë **“Sunrise Beach Hotel” shpk** u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), janë ato që percaktohen në statutin e shoqërisë, **Të drejtat** që shoqëria pritesë **“Luxury Premium Finese” shpk** u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), janë ato që percaktohen në statutin e shoqërisë, të drejta keto në zbatim të ligjit 9901 datë 14.04.2008 për “Tregetaret dhe Shoqëritë Tregetare”.
7. **Përparësitë** apo kufizimet e Administratoreve të shoqërive se reja pas ndarjes do të jenë ato që i njeh statuti i sejciles shoqëri në zbatim të ligjit 9901 datë 14.04.2008 për “Tregetaret dhe Shoqëritë Tregetare”.
8. **Pasojat** e ndarjes nuk do të kenë asnjë influencë ndaj të punësuarve të shoqërisë që marr pjesë në procesin e ndarjes.
9. **Pasojat** e ndarjes nuk do të kenë asnjë influencë ndaj të tremeve të shoqërisë para ndarjes.
10. **Ortak i Vetëm** i shoqërisë pritesë **“Sunrise Beach Hotel” shpk** do të jete Enver Mehmeti dhe **Ortak i Vetëm** i shoqërisë pritesë **“Luxury Premium Finese” shpk** do të jete Arben Meçaj.
11. **Emrat e shoqërive** se krijuar nga ndarja do të jenë: shoqëria pritesë **“Sunrise Beach Hotel” shpk** dhe shoqëria pritesë **“Luxury Premium Finese” shpk**.
12. **Selite e shoqërive** se reja pritesë do të jenë:
 - a) Per shoqërine pritesë **“Sunrise Beach Hotel” shpk** Lagja Mjull Bathore, Rruga Dervish Shaba, Rrethrotullimi i qendres tregetare TEG, Blloku B1, Tirane.
 - b) Per shoqërine pritesë **“Luxury Premium Finese” shpk** Hotel “Premium” Kryemedhenj, Golem Kavaje.
13. **Statuti i shoqërive** se reja pas ndarjes do të jete i veçantë për sejcilen shoqëri.
14. **Objekti veprimtarisë i shoqërive** se reja pas ndarjes do të jete i veçantë për sejcilen shoqëri që do të percaktohet në statutin e sejciles.
15. **Administratori i shoqërisë pritesë “Sunrise Beach Hotel” shpk** do të jete Enver Mehmeti me një mandat 5 vjeçar dhe **Administratori i shoqërisë pritesë “Luxury Premium Finese” shpk** do të jete Mimoza Meçaj me një mandat 5 vjeçar.
16. **Baza e nisjes** për ndarjen do të jenë treguesit e bilancit të datës 31.12.2024, ndërsa aktiviteti i vitit 2025 do të jete i përbashkët me sistemit e nevojshme sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar në zbatim të ligjit 25/2018 dt. 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
17. **Kapitali themeltar dhe Përqindjet** (të trajtuara në pikën 2 dhe 3 si më sipër) e sejcilit ortak në kapitalin themeltar për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të krijuara nga ndarja, do të percaktohen pas paraqitjes së raportit nga Shoqëria Audituese “Gosnishti Auditors And Partners” shpk, në zbatim të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregetaret dhe Shoqëritë Tregetare”, Neni 217, pika 1.
18. **Fitimi nga kapitali i tatueshem** në zbatim të ligjit 29/2023 datë 30.03.2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", Neni 46, pika 2 ku theksohet “Një riorganizim biznesi nuk shkakton tatim të fitimeve kapitale mbi aktivet e transferuara për t'i dhënë efekt riorganizimit, përveç ndonjë pagese në para që tejkalon pagesën e cilësuar në të holla”, dhe Udhezimit të përgjithshëm 26 datë 08.09.2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", pika 46.1 ku theksohet Fitimi kapital nuk tatohet në momentin e riorganizimeve të biznesit të tilla si bashkimet, ndarjet, ndarjet e pjesshme, shkëmbimi i aksioneve dhe transferimet e degëve të veprimtarisë. Kjo lejon zhvillim dhe rritje pa probleme të ndërmarrjeve, bashkimi me përthithje bëhet mbi bazën e bashkimit të kapitaleve të të dyja shoqërive dhe nuk ka pagesë në para që tejkalon pagesën e cilësuar në të holla.

19. **Caktimin e Audituesit Ligjor** Shoqerine Audituese “Gosnishti Auditors And Partners” shpk me Nipt-in L32423013P, e regjistruar ne regjistrin publik te Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar (IEKA) me Nr. 389 date 31.03.2014, ne zbatimin te pikes 17 si me siper, per caktimin e kontributeve te dy shoqerive pritesë, “**Sunrise Beach Hotel**” shpk dhe “**Luxury Premium Finese**” shpk pas ndarjes e shoqerise “**Premium Finese**” shpk e cila ne fund te ketij procesi do te vleresohet e prishur (Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, Neni 227,pika 1) .
20. **Bilanci i ndarjes** do te kete si baze treguesit e bilancit te vitit 2024-te shoqerise “**Premium Finese**” shpk.
21. **Shoqeria “Premium Finese” shpk** si shoqëri ne ndarje, e cila ne fund te ketij procesi do te vleresohet e prishur (Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, Neni 227,pika 1), ne zbatim te pikes 7 te nenit 216 te ligjit 9901 date 14.4.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, perjashtojne detyrimin për pasqyrat kontabël të përmendura në pikën 5, si dhe të njoftimit sipas pikës 6, po te nenit 216 te ligjit 9901 date 14.4.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”

Per Shoqerine ndarese “**Premium Finese**” shpk

Perfaqesuesi Ligjor

Arben Meçaj



VO:

Projekt mareveshja si me siper u lexua nga ortaket para mbledhjes se Asamblese Ortakeve te shoqerise “**Premium Finese**” shpk.

Ortaku Arben Meçaj

Ortaku Enver Mehmeti